

Liga Arabe dënoi ashpër sulmet e regjimit të Esadit ndaj civilëve në Haleb dhe rrethinë.

Pas thirrjes së Katarit, përfaqësuesit e vendeve anëtare të Ligës Arabe u mbledhën në një mbledhje të jashtëzakonshme në lidhje me gjendjen në Siri.

Në mbledhjen e kryesuar nga ana e Bahrejit mori pjesë edhe Sekretari i Përgjithshëm i Ligës Arabe, Nebil el Arabi.

Në konferencën për shtyp të organizuara pas mbledhjes zëvendëssekretari i përgjithshëm i Ligës Arabe, Ahmed bin Hillu deklaroi se dënojnë ashpër dhunën e regjimit të Esadit ndaj civilëve në Haleb.

Duke e bërë të ditur se sulmet janë në kundërshtim me konventat ndërkombëtare, Hillu tha: “I bëjmë thirrje Këshillit të Sigurisë të Kombeve të Bashkuara për tu vënë sa më parë në veprim dhe për të marr vendimet e duhura që regjimi sirianë të ndaloj sulmet në mbarë vendin”.

Hillu i bëri thirrje edhe shoqërisë ndërkombëtare për të hedhur hapat e duhura që palët e përfshira në këto sulme të gjykojnë në gjykatën ndërkombëtare.